



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 248

Tiranë – E enjte, 14 janar 2016

## PËRMBAJTJA

|                                                                                                                                                 | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Dekret i Presidentit<br>nr. 9378, datë 29.12.2015                                                                                               | Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 16925                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Udhëzim i ministrit të Arsimit<br>dhe Sportit<br>nr. 50, datë 3.11.2015                                                                         | Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi të ciklit të dytë më kohë të plotë “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, në Universitetin e Arteve, Tiranë, në vitin akademik 2015–2016..... 16925                                                                               |
| Udhëzim i ministrit të Arsimit<br>dhe Sportit<br>nr. 51, datë 1.12.2015                                                                         | Për procedurën e pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për shtetasit e huaj që kërkojnë të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2015–2016..... 16927                                                                          |
| Udhëzim i ministrit të Arsimit<br>dhe Sportit<br>nr. 52, datë 3.12.2015                                                                         | Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë..... 16929                                                                                                                                                                             |
| Udhëzim i ministrit të Arsimit<br>dhe Sportit<br>nr. 53, datë 16.12.2015                                                                        | Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 37, datë 5.10.2015, “Për procedurën e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, të ofruara nga institucionet private të arsimit të lartë, si dhe për transferimin e studimeve në programet e studimit të ofruara nga këto institucione, për vitin akademik 2015–2016”, të ndryshuar..... 16930 |
| Vendim i Entit Rregullator të<br>Sektorit të Furnizimit me Ujë<br>dhe Largimit e Përpunimit të<br>Ujërave të Ndotura<br>nr. 31, datë 15.10.2015 | Për një ndryshim në vendimin nr. 18, datë 14.7.2014, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Durrës”..... 16931                                                                                                                                                                                                                                                     |

|                                                                                                                                        |                                                                                                                                                        |       |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura<br>nr. 34, datë 23.11.2015 | Për tarifën e shitjes së ujit me shumicë për sh.a. UK Sarandë.....                                                                                     | 16931 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura<br>nr. 35, datë 23.11.2015 | Për mosshqyrtim të propozimit për ndryshim tarife për sh.a. UK Lezhë.....                                                                              | 16931 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura<br>nr. 39, datë 9.12.2015  | Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.....                              | 16932 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura<br>nr. 40, datë 9.12.2015  | Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura..... | 16937 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura<br>nr. 41, datë 9.12.2015  | Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura.....                   | 16939 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura<br>nr. 42, datë 9.12.2015  | Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura.....           | 16946 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura<br>nr. 43, datë 21.12.2015 | Për një ndryshim në vendimin nr. 9, datë 30.4.2012, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjiellës Selenicë”.....                                              | 16954 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura<br>nr. 44, datë 21.12.2015 | Për një ndryshim në vendimin nr. 13, datë 13.6.2012, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjiellës Bulqizë”.....                                              | 16954 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura<br>nr. 45, datë 21.12.2015 | Për shfuqizim vendimi.....                                                                                                                             | 16955 |
|                                                                                                                                        | Ndreqje gabimi teknik.....                                                                                                                             | 16955 |

**DEKRET****Nr. 9378, datë 29.12.2015****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

**DEKRETOJ:****Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Kozeta Vangjel Bardhi
2. Ilëla Ilir Kraja
3. Besnik Skender Psatha

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË  
Bujar Nishani**

**UDHËZIM****Nr. 50, datë 3.11.2015**

**PËR ZHVILLIMIN E KONKURSEVE TË  
PRANIMIT, TARIFËN E REGJISTRIMIT  
PËR KONKURRIM NË DISA  
PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË  
DYTË MË KOHË TË PLOTË “MASTER  
PROFESIONAL” DHE “MASTER I  
SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE TË  
BUKURA”, NË UNIVERSITETIN E  
ARTEVE, TIRANË, NË VITIN  
AKADEMIK 2015–2016**

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 26, 34 dhe 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 135 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, vendimin nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimit dhe tarifave të studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike

të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015–2016”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Pranimet në programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vitin akademik 2015–2016, në Universitetin e Arteve, Tiranë, bëhen mbi bazën e rezultateve të ciklit të parë dhe të rezultateve të fituara nga konkursi i pranimit, i organizuar nga ky institucion publik i arsimit të lartë.

2. Rezultatet e ciklit të parë (nota mesatare e viteve të shkollimit), të llogariten në masën 30% dhe rezultatet e konkursit të pranimit në masën 70%, sipas tabelës nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

3. Për të gjitha programet e studimit, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, pikët minimale dhe maksimale të konkurseve përcaktohen në tabelën nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4. Rregulloret dhe programet e konkurseve, të miratuara nga Universiteti i Arteve, Tiranë, të bëhen publike, duke filluar nga data 3 nëntor 2015.

5. Rektorati dhe dekanatet e Universitetit të Arteve, Tiranë, të shpallin në mjediset e tyre, si dhe në faqet *web* përkatëse deri në datën 3 nëntor 2015, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për të siguruar një ecure normale të procesit të regjistrimit në konkursin e pranimit në ciklin e dytë me kohë të plotë.

6. Kandidatët brenda vendit, si edhe kandidatët shqiptarë, që do të marrin pjesë në konkurse të pranimit për këto programe studimi, nga Republika e Kosovës, nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Malit të Zi dhe nga Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, të regjistrohen për zhvillimin e konkursit pranë sekretarive mësimore të fakultetit përkatës, nga data 3 nëntor 2015 deri në orën 12:00 të datës 6 nëntor 2015.

7. Sekretaritet mësimore të fakulteteve përkatëse, pas verifikimit të listave të të regjistruarve, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, i përcjellin dekanatit listat e aplikantëve për shpallje dhe afishim në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16:00, të datës 6.11.2015.



8. Konkursset e pranimit të zhvillohen në datat 10–12 nëntor 2015.

9. Tarifa e regjistrimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkursset e pranimit është 3,000 lekë.

10. Konkursset e pranimit monitorohen nga përfaqësues të MAS-it.

11. Rezultatet e konkurseve të pranimit të dërgohen në MAS e në AKP, në formë shkresore dhe elektronike në CD, brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre.

12. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe Universiteti i Arteve, Tiranë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Lindita Nikolla**

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT (TABELA NR. 1)  
PËRQINDJA QË ZË MESATARJA E VITEVE TË SHKOLLIMIT NË CIKLIN E PARË NË PIKËT FINALE  
PËR PRANIMIN NË CIKLIN E DYTË NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, TIRANË

|    | EMËRTIMI I UNIVERSITETIT      | ID e PROGRAMIT | EMËRTIMI I PROGRAMIT        | Lloji i programit         | Nota mesatare e viteve të shkollimit | % e Konkursit të Pranimit |
|----|-------------------------------|----------------|-----------------------------|---------------------------|--------------------------------------|---------------------------|
| 1  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 189            | Kitarë                      | Master profesional        | 30                                   | 70                        |
| 2  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 190            | Fizamonike                  | Master profesional        | 30                                   | 70                        |
| 3  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 191            | Pedagogji Muzikore          | Master profesional        | 30                                   | 70                        |
| 4  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 192            | Aktrim                      | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 5  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 193            | Koreografi                  | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 6  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 194            | Regji Filmi dhe Televizioni | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 7  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 195            | Regji teatri dhe spektakli  | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 8  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 196            | Skenografi - Kostumografi   | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 9  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 197            | Piano                       | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 10 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 198            | Violinë                     | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 11 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 199            | Violonçel                   | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 12 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 200            | Këngë lirike                | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 13 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 201            | Kontrabas                   | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 14 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 202            | Flaut                       | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 15 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 203            | Klarinetë                   | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 16 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 204            | Oboe                        | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 17 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 205            | Trombë                      | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 18 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 206            | Korno                       | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 19 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 207            | Trombonë                    | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 20 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 208            | Dirizhim                    | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 21 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 209            | Kompozim                    | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 22 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 210            | Muzikologji                 | Master i shkencave        | 30                                   | 70                        |
| 23 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 211            | Pikturë grafike             | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 24 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 212            | Pikturë tekstili dhe modë   | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 25 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 213            | Pikturë multimedia          | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 26 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 214            | Pikturë kavaleti            | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 27 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 215            | Pikturë monumentale         | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 28 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 216            | Skulpturë                   | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |
| 29 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 217            | Skulpturë qeramike          | Master i arteve të bukura | 30                                   | 70                        |



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT (TABELA NR. 2)  
PIKËT MAKSIMALE DHE MINIMALE SIPAS PROGRAMEVE NË KONKURSET E PRANIMIT

|    | EMËRTIMI I UNIVERSITETIT      | ID e PROGRAMIT | EMËRTIMI I PROGRAMIT        |                           | Pikët maksimale | Pikët minimale |
|----|-------------------------------|----------------|-----------------------------|---------------------------|-----------------|----------------|
| 1  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 189            | Kitarë                      | Master profesional        | 100             | 40             |
| 2  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 190            | Fizarmonikë                 | Master profesional        | 100             | 40             |
| 3  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 191            | Pedagogji Muzikore          | Master profesional        | 100             | 40             |
| 4  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 192            | Aktrim                      | Master i arteve të bukura | 100             | 50             |
| 5  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 193            | Koreografi                  | Master i arteve të bukura | 100             | 50             |
| 6  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 194            | Regji Filmi dhe Televizioni | Master i arteve të bukura | 100             | 50             |
| 7  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 195            | Regji teatri dhe spektakli  | Master i arteve të bukura | 100             | 50             |
| 8  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 196            | Skenografi - Kostumografi   | Master i arteve të bukura | 100             | 50             |
| 9  | Universiteti i Arteve, Tiranë | 197            | Piano                       | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 10 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 198            | Violinë                     | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 11 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 199            | Violonçel                   | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 12 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 200            | Këngë lirike                | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 13 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 201            | Kontrabas                   | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 14 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 202            | Flaut                       | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 15 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 203            | Klarinetë                   | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 16 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 204            | Oboe                        | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 17 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 205            | Trombë                      | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 18 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 206            | Korno                       | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 19 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 207            | Trombonë                    | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 20 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 208            | Dirizhim                    | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 21 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 209            | Kompozim                    | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 22 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 210            | Muzikologji                 | Master i shkencave        | 100             | 40             |
| 23 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 211            | Pikturë grafike             | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 24 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 212            | Pikturë tekstili dhe modë   | Master i arteve të bukura | 100             | 40             |
| 25 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 213            | Pikturë multimedia          | Master i arteve të bukura | 100             | 50             |
| 26 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 214            | Pikturë kavaleti            | Master i arteve të bukura | 100             | 50             |
| 27 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 215            | Pikturë monumentale         | Master i arteve të bukura | 100             | 50             |
| 28 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 216            | Skulpturë                   | Master i arteve të bukura | 100             | 50             |
| 29 | Universiteti i Arteve, Tiranë | 217            | Skulpturë qeramike          | Master i arteve të bukura | 100             | 50             |

## UDHËZIM

Nr. 51, datë 1.12.2015

**PËR PROCEDURËN E PRANIMIT NË  
PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT  
TË DYTË ME KOHË TË PLOTË,  
“MASTER PROFESIONAL” DHE  
“MASTER I SHKENCAVE”/“MASTER I  
ARTEVE TË BUKURA”, PËR  
SHTETASIT E HUAJ QË KËRKOJNË TË  
STUDIOJNË NË INSTITUCIONET  
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË  
VITIN AKADEMIK 2015–2016**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, pikës 1/“ç”, të pikës 6 dhe pikës 16,

të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015–2016”, të ndryshuar,

## UDHËZOJ:

1. Studentët e huaj që aplikojnë individualisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit apo në kuadër të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe ose shumëpalëshe, për ndjekjen e studimeve në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2015–2016, të



përzgjidhen për programin e studimit të kërkuar, në bazë të dosjeve të aplikantëve të përcjella individualisht nga vetë të interesuarit ose të ardhura nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, nga ministritë e arsimit të vendeve përkatëse ose nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

2. Studentët e huaj, duhet të paraqesin në Drejtorinë e Integritimit dhe Projekteve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, deri në datën 4 dhjetor 2015 dokumentet e mëposhtme:

a) Formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) Vërtetim që nuk ka qenë i ndjekur penalisht dhe që nuk është në ndjekje penale, në vendin e origjinës, i lëshuar 3 muajt e fundit;

c) Fotokopjen e dokumentit personal të identitetit;

d) Fotokopjen të njësuar me origjinalin të vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë të diplomës së ciklit të parë të studimeve të shoqëruar me kopje të njësuar me origjinalin të diplomës ose të listës së notave;

e) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri;

f) Kopjen e njësuar të origjinalit të lejeqëndrimit për shtetasit e huaj, lëshuar nga Ministria e Brendshme, nëse disponohet nga aplikuesi;

g) *Curriculum Vitae*;

h) Deklaratën sipas shtojcës nr. 2 të këtij udhëzimi.

3. Kur dokumentacioni paraqet mangësi, Drejtoria e Integritimit dhe Projekteve i kërkon aplikantit plotësimin e tij brenda datës 9 dhjetor 2015. Drejtoria e Integritimit dhe Projekteve dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, shqyrtojnë

dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi dhe, në rastet kur numri i kërkesave është më i lartë se ai i kuotave të miratuara për shtetasit e huaj për ciklin përkatës të studimit, bëjnë renditjen e kandidatëve sipas kriterit të meritës dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues në programet e studimit përkatës, bazuar dhe në kapacitetet pritëse të IAL-ve. Kërkesat e aplikantëve që nuk kanë dorëzuar dokumentacion të plotë, sipas specifikimeve në këtë udhëzim brenda afateve të parashikuara, nuk do të merren në shqyrtim.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit u dërgon institucioneve publike të arsimit të lartë, brenda datës 15 dhjetor 2015, dokumentacionin përkatës të aplikantëve të përzgjedhur sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, për të kryer procedurat e mëtejshme të regjistrimit në programet e studimit përkatës.

5. Shtetasit e huaj, brenda datës 23 dhjetor 2015, paraqiten pranë sekretarive mësimore të fakulteteve përkatëse për të përfunduar procedurat e regjistrimit në programin përkatës të studimit.

6. Brenda datës 28 dhjetor 2015, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKP) listat përfundimtare në dy kopje, në formë të shkruar dhe elektronike, me regjistrimet e kryera për shtetasit e huaj, për çdo program studimi, të plotësuar, sipas shtojcës nr. 3 të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, i ndryshuar. AKP-i përgatit dhe u përcjell IAL-ve përkatëse numrat e matrikullimit të shtetasve të huaj brenda datës 15 janar 2016.

7. Ngarkohen, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Drejtoria e Integritimit dhe Projekteve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet publike të arsimit të lartë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Lindita Nikolla**

**UDHËZIM****Nr. 52, datë 3.12.2015****PËR PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË  
GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE  
NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET  
NË PROGRAMET E STUDIMIT TË  
CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË, NË  
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4, të nenit 76 dhe pikës 3, të nenit 78, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

1. Përcaktimin e niveleve dhe testeve ndërkombëtare të 5 (pesë) gjuhëve të huaja, përkatësisht: gjuhës angleze, gjuhës frënge, gjuhës gjermane, gjuhës italiane dhe gjuhës spanjolle. Kandidatët, të cilët aplikojnë për t'u pranuar në programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë në institucionet e arsimit të lartë, duhet të kenë nivel të njohjes së njërës prej gjuhëve të huaja, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.

2. Klasifikimi i aftësive gjuhësore dhe niveleve të njohjes së gjuhëve, bëhet sipas tabelës bashkëlidhur këtij udhëzimi në referencë të pikëve të testeve të ndryshme ndërkombëtare dhe shërben si standard për njohjen e gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare përkatëse në Shqipëri.

3. Për pranimin në programet e studimit të ciklit të dytë kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, ndërmjet nivelit B1 dhe nivelit C1. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloret e tyre nivelin e gjuhës, që do të jetë kriter hyrës në programet e studimit të ofruara prej tyre në ciklin e dytë, brenda niveleve të sipërcituara në këtë pikë të udhëzimit. Për pranimin në programin e studimeve të ciklit të tretë, kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, të nivelit C1.

4. Kandidati që aplikon për t'u pranuar në programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë në institucionin e arsimit të lartë, duhet të ketë certifikime dhe rezultate të testeve ndërkombëtare për nivelet e njohjes së gjuhëve, të cilat i përkasin një periudhe jo më vonë se 2 (dy) vjet nga momenti i lëshimit të tyre.

5. Dokumenti i njohjes së gjuhëve, mund të jetë

një certifikatë, diplomë apo dëshmi, e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare.

6. Institucionet e arsimit të lartë duhet të shpallin në faqen zyrtare dhe ambientet e tyre:

a) Listën e niveleve të njohjes së gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare në referencë të përcaktimeve të tabelës 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi, të përcaktuar si kriter pranimi në programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë në atë institucion;

b) Listën e subjekteve të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testimet ndërkombëtare.

7. Institucionet e arsimit të lartë duhet të garantojnë akses dhe mundësi të barabarta për të gjitha subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testimet ndërkombëtare dhe certifikimin të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

8. Institucionet e arsimit të lartë, përcaktojnë në rregulloret e tyre, modalitetet e dorëzimit dhe verifikimit të certifikimit të nivelit të njohjes së gjuhës së huaj, në përputhje me procedurat e tjera të pranimin të kandidatit në programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë.

9. Subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale për ofrimin e testeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, certifikimet e të cilëve do të shërbejnë në përmbushjen e detyrimit ligjor, duhet të:

a) Paraqesin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dokumentacionin ligjor për të drejtën e pronësisë intelektuale dhe ofrimin e testeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas procedurave dhe afateve kohore të publikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

b) Nënshkruajnë marrëveshjen me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me qëllim njohjen e të drejtës së subjektit për ofrimin e testeve, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, shkëmbimin e informacionit në lidhje me testimet ndërkombëtare, si dhe ofrimin e të dhënave për të gjithë kandidatët që aplikojnë në institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë.

10. Subjektet që ofrojnë kurse përgatitore, për prodhimin ose/dhe shpërndarjen e teksteve didaktike të gjuhëve të huaja, nuk mund të jenë ofruese të shërbimit të testeve dhe certifikimeve ndërkombëtare.



11. Studentët e regjistruar në ciklin e dytë apo të tretë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë, të cilët nuk i janë nënshtruar testimit të gjuhës angleze, si dhe nuk kanë paraqitur dokumentacion pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas udhëzimit nr. 14, datë 28.3.2011, “Për njohjen e testeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, kryejnë testimin sipas këtij udhëzimi.

12. Udhëzimi i ministrit të MASH-it nr. 14, datë 28.3.2011, “Për njohjen e testeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e

studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, shfuqizohet.

13. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

**Lindita Nikolla**

**Tabela 1**

Në mbështetje të Kuadrit të Referencave për Gjuhët të krijuar nga Këshilli i Europës (2001), Kuadrit të Përbashkët Europian të Referencave për Gjuhët, si dhe në bashkëpunim me Ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Spanjës të akredituara në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, njëj testet e gjuhëve të huaja dhe nivelet si më poshtë:

| Niveli                                 | B1                    | B2                     | C1                    |
|----------------------------------------|-----------------------|------------------------|-----------------------|
| <b>Gjuha angleze</b>                   |                       |                        |                       |
| <b>Cambridge</b>                       | <b>PET</b>            | <b>FCE</b>             | <b>CAE</b>            |
| <b>IELTS</b>                           | <b>4.0 / 5.0</b>      | <b>5.5 / 6.0</b>       | <b>6.5 / 7.0</b>      |
| <b>TOEFL Internet-based Test (IBT)</b> | <b>57/86</b>          | <b>87/109</b>          | <b>110/120</b>        |
| <b>TOEFL Paper-based Test (ITP)</b>    | <b>460</b>            | <b>543</b>             | <b>627</b>            |
| <b>TOEIC</b>                           | <b>381 / 649</b>      | <b>650/ 785</b>        | <b>786 / 935</b>      |
| <b>GESE</b>                            | <b>-</b>              | <b>7, 8, 9</b>         | <b>10, 11</b>         |
| <b>APTIS</b>                           | <b>Aptis B1</b>       | <b>Aptis B2</b>        | <b>Aptis C</b>        |
| <b>Gjuha gjermane</b>                  |                       |                        |                       |
| <b>Goethe-Institut</b>                 | <b>ZD</b>             | <b>ZDFB</b>            | <b>ZMP</b>            |
| <b>TestDaF</b>                         | <b>-</b>              | <b>TDN 3 - TDN4</b>    | <b>TDN 5</b>          |
| <b>Gjuha franceze</b>                  |                       |                        |                       |
| <b>TEF</b>                             | <b>345/604</b>        | <b>605/824</b>         | <b>825</b>            |
| <b>DELF</b>                            | <b>DELF B1</b>        | <b>DELF B2</b>         | <b>DALFC1</b>         |
| <b>TCF</b>                             | <b>TCF 300 - 399</b>  | <b>TCF 400 - 499</b>   | <b>TCF 500 - 599</b>  |
| <b>TEF</b>                             | <b>TEF 361-540</b>    | <b>TEF 541-698</b>     | <b>TEF 699-833</b>    |
| <b>Gjuha italiane</b>                  |                       |                        |                       |
| <b>Peruggia</b>                        | <b>CELI2 livello2</b> | <b>CELI3 livello3</b>  | <b>CELI4 livello4</b> |
| <b>Sienna</b>                          | <b>CILS uno B1</b>    | <b>CILS 2</b>          | <b>CILS 3</b>         |
| <b>Gjuha spanjolle</b>                 |                       |                        |                       |
| <b>DELE</b>                            | <b>DELE inicial</b>   | <b>DELE intermedio</b> | <b>DELE superior</b>  |

## UDHËZIM

Nr. 53, datë 16.12.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË  
UDHËZIMIN NR. 37, DATË 5.10.2015,  
“PËR PROCEDURËN E PRANIMIT DHE  
TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E  
STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE  
TË DYTË, TË OFRUARA NGA  
INSTITUCIONET PRIVATE TË  
ARSIMIT TË LARTË, SI DHE PËR  
TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË  
PROGRAMET E STUDIMIT, TË  
OFRUARA NGA KËTO INSTITUCIONE,  
PËR VITIN AKADEMIK 2015–2016”,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

## UDHËZOJ:

1. Në pikën 3, të udhëzimit nr. 37, datë 5.10.2015, datat “23 tetor 2015” dhe “13 nëntor 2015” ndryshohen në “21 dhjetor 2015”.

2. Në pikën 5, të udhëzimit nr. 37, datë 5.10.2015, datat “6 nëntor 2015” dhe “27 nëntor 2015” ndryshohen në “28 dhjetor 2015”.

3. Në pikën 5, të udhëzimit nr. 37, datë 5.10.2015, datat “7 dhjetor 2015” dhe “28 dhjetor 2015” ndryshohen në “28 janar 2016”.



4. Në pikën 6, të udhëzimit nr. 37, datë 5.10.2015, datat “28 dhjetor 2015” dhe “15 janar 2015” ndryshohen në “1 shkurt 2015”.

5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si edhe institucionet private të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT**  
**Lindita Nikolla**

#### **VENDIM**

**Nr. 31, datë 15.10.2015**

#### **PËR NJË NDRYSHIM NE VENDIMIN NR. 18, DATË 14.7.2014, “PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS- KANALIZIME DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/“a”, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

#### **VENDOSI:**

1. Pika 4 e vendimit nr. 18, datë 14.7.2014, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Durrës”, ndryshohet si më poshtë:

“Kjo licencë është e vlefshme deri më datë 21.4.2017”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**

#### **VENDIM**

**Nr. 34, datë 23.11. 2015**

#### **PËR TARIFËN E SHITJES SË UJIT ME SHUMICË PËR SHA UK SARANDË**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

dhe metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, Komisioni Kombëtar Rregullator

#### **VENDOSI:**

1. Të mos i miratojë sh.a. UK Sarandë tarifën e shitjes së ujit me shumicë për fshatin Vriion të Bashkisë Finiq.

2. Sh.a. UK Sarandë do të vazhdojë të furnizojë më ujë fshatin Vriion deri në përfundim të procedurave që lidhen me ristrukturimin e shërbimit të furnizimit me ujë për Bashkinë Finiq.

3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Tekniko-Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**

#### **VENDIM**

**Nr. 35, datë 23.11.2015**

#### **PËR MOSSHQYRTIM TË PROPOZIMIT PËR NDRYSHIM TARIFE PËR SHA UK LEZHË**

Në mbështetje të neneve 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe neneve 12 dhe 15 të metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, Komisioni Kombëtar Rregullator

#### **VENDOSI:**

1. Të mos marrë në shqyrtim propozimin për ndryshim tarife për vitin 2016 për “Ujësjiellës-Kanalizime Lezhë” sh.a.

2. Propozimi për ndryshimin e tarifave duhet të riparaqitet i plotësuar me shifra të aktualizuara dhe dokumentacionin e munguar në vitin e ardhshëm.

3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Tekniko-Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**

**VENDIM****Nr. 39, datë 9.12.2015****PËR MIRATIMIN E POLITIKËS  
TARIFORE PËR SHËRBIMIN E  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E  
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË  
NDOTURA**

Në zbatim të neneve 14 dhe nenit 22, pika 1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Të miratojë politikën tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, e detyrueshme të zbatohet nga të gjithë operatorët që ofrojnë këto shërbime, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë e pandarë e tij.

2. Objektivi i Entit Rregullator të Ujit (ERRU) nëpërmjet politikës së vendosjes së tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura është:

- Të mbrojë konsumatorët;
- T’u bëjë të mundur të licencuarve të rikuperojnë kostot e arsyeshme të kryerjes së një shërbimi efektiv, duke përfshirë dhe mundësinë për të siguruar një fitim mbi investimin e tij, që është i mjaftueshëm për përmirësime dhe ndërtime të reja;
- Të inkurajojë efikasitetin në operacionet e brendshme, duke bërë të mundur rritjen e fitimit financiar të të licencuarit nëpërmjet rritjes së të ardhurave bruto nga reduktimi i humbjeve joteknike apo i uljes së kostove të shërbimit, me kusht që i licencuari të përmbushë të gjitha kërkesat e licencës së tij në lidhje me kryerjen dhe cilësinë e shërbimit dhe kërkesa të tjera të aplikueshme kontraktuese;
- Të inkurajojë efikasitetin ekonomik brenda sektorit, duke dhënë sinjale të sakta të çmimeve në lidhje me ofertën e tepërt apo të pakët;
- Të pasqyrojë hapur dhe qartë subvencionet e dhëna nga qeveria;
- Të pasqyrojë ndryshimet në kosto dhe në aspekte të tjera midis klasave të klientëve dhe llojeve të shërbimit, në varësi të subvencioneve që do të aplikohen;

- T’u japë mundësi të licencuarve të respektojnë ligjet për mbrojtjen e mjedisit.

3. Niveli i tarifës bazohet në politikën tarifore dhe përcaktohet sipas metodologjisë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, miratuar nga ERRU-ja.

4. Bazë për vlerësimin e aplikimit për nivelin e tarifës së shërbimeve ujësjellës-kanalizime është metodologjia “Për vendosjen e tarifave” dhe “Justifikimi i nivelit të kërkuar të tarifës - Modeli i aplikimit”, të cilat përgatiten sipas një procesi, manualeve përkatëse për përdoruesit dhe dokumenteve tip të përgatitura dhe vënë në dispozicion për operatorët nga ERRU-ja.

5. Vendimi i KKRR-së nr. 28, datë 28.9.2011, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI  
Avni Dervishi**

**POLITIKA TARIFORE  
PËR SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË  
DHE LARGIMIN E PËRPUNIMIT E  
UJËRAVE TË NDOTURA**

Misioni i Entit Rregullator të Ujit (ERRU) është t’u garantojë konsumatorëve shqiptarë shërbime furnizimi me ujë dhe kanalizimesh cilësore, efeciente dhe me çmim të drejtë. Tarifat janë vendimtare për arritjen e këtij ekuilibri, si edhe për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit në tërësi. Mandati i ERRU-së i përcaktuar në ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996, i ndryshuar, është mbrojtja e konsumatorëve duke vendosur stimuj që inkurajojnë efikasitetin dhe përmirësimet e ofrimit të shërbimit të konsumatorëve, por dhe duke u mundësuar operatorëve mbulimin e të gjitha kostove të arsyeshme që lindin nga ofrimi i këtyre shërbimeve.

**KREU 1  
POLITIKA PËR VENDOSJEN E TARIFËS  
PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E  
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA****Neni 1  
Përkufizime**

“Enti Rregullator i Ujit (ERRU)” është institucioni i pavarur që rregullon sektorin e



furnizimit me ujë, të largimit dhe të përpunimit të ujërave të ndotura në përputhje me ligjin nr. 8102 (i ndryshuar).

“Komisioni” është Komisioni Kombëtar Rregullator që udhëheq Entin Rregullator të Ujit që funksionon në bazë të ligjit nr. 8102 (i ndryshuar).

“Konsumatorë” janë të gjitha kategoritë familjare, publike dhe private të cilat përdorin shërbimet e furnizimit me ujë dhe/ose kanalizimeve.

“Konsumator publik” nënkupton çdo person/subjekt ligjor të klasifikuar si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare (ambasada, konsullata dhe rezidenca diplomatike), selitë e partive politike dhe degëve të tyre, si dhe çdo institucion i cili kryen aktivitet me interes të përbashkët ose publik që nuk është regjistruar si organizatë fitimprurëse.

“Ente private” nënkupton çdo person/subjekt ligjor ose organizatë fitimprurëse që ushtron veprimtari tregtare apo industriale të çfarëdolloji përfshi edhe shoqëritë tregtare shtetërore (KESH sh.a., ndërmarrjet e trajtimit të studentëve e të tjera të ngjashme).

“Operator” është subjekti i licencuar nga ERRU-ja që ushtron aktivitetet e shërbimit të furnizimit me ujë, largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura dhe ofron një ose disa nga këto shërbime sipas kategorive të përcaktuara në licencë.

“Zona e juridiksionit” është zona ku operatori i licencuar është përgjegjës të ofrojë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

“Sistemi i furnizimit me ujë” përbëhet nga tërësia e elementeve, si vepra e marrjes, sistemi i pompave, njësitë e dezinfektimit, rezervuarët, linjat e transmetimit dhe rrjeti shpërndarës.

“Sistemi i kanalizimeve” është sistemi që përbëhet nga tërësia e elementeve, si linjat e shkarkimit/grumbullimit të ujërave të ndotura, linjat e largimit dhe/ose stacionet e pompimit të ujërave të ndotura, veprat e shkarkimit të tyre në trupat ujorë pritës, si dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura (nëse sistemi është i pajisur me to).

“Shërbimet UK” është tërësia e shërbimeve të kryera nga operatorët të konsumatorët përmes sistemeve të furnizimit me ujë, si dhe sistemeve të grumbullimit, largimit dhe/ose trajtimit të ujërave të ndotura.

“Sistemi i tarifave” nënkupton parametrat, kriteret dhe standardet e përdorura për përcaktimin e tarifës për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime për kategori të ndryshme konsumatorësh dhe nivele të ndryshme konsumi.

“Faktorët e strukturës së tarifës” i referohen peshës relative të tarifës së dhënë për njësinë e volumit të konsumit të ujit ndërmjet grupeve të ndryshme të konsumatorëve dhe niveleve të ndryshme të konsumit.

“Tarifa e ujit” është çmimi që konsumatorët duhet të paguajnë për shërbimin e furnizimit me ujë të ofruar nga operatorët nëpërmjet rrjetit shpërndarës. I njëjti term përdoret zakonisht edhe për tarifën e kanalizimeve (grumbullimin, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura). Tarifa e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve vendosen për të mbuluar koston e prodhimit, trajtimit të ujit, depozitimin dhe shpërndarjes së tij të konsumatorët, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, si edhe faturimin dhe mbledhjen e të ardhurave nga këto shërbime.

“Tarifa me dy pjesë” përbëhet nga komponenti volumetrik dhe nga komponenti fiks i tarifës. Komponenti volumetrik përcaktohet si çmim/m<sup>3</sup>. Komponenti fiks i tarifës është një çmim fiks në vit ose në muaj. Tarifa me dy pjesë mund të aplikohet vetëm në rastet kur matësit janë të instaluar dhe lexohen. Përndryshe aplikohet një “tarifë aforfe”.

“Tarifë për shërbime të tjera” është termi i përdorur për të gjitha shërbimet e tjera të ofruara nga operatori, të cilat nuk janë pjesë e faturimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, por që duhet të paguhet nga konsumatori.

“Shitja e ujit me shumicë” është situata në të cilën uji shitet te një blerës nga një ose disa pika shpërndarjeje me qëllimin e rishitjes së tij për konsumatorët individualë brenda zonës së shërbimit të blerësit me shumicë.

“Tarifë mesatare” është mesatarja që rezulton nga totali i të ardhurave sipas volumit të faturuar me tarifat e kombinuara (tarifë volumetrike + tarifë fikse/tarifë e sheshtë), mbi totalin e volumit të faturuar, për një afat kohor (muaj/tremujor ose vit).

“Të ardhurat” nënkuptojnë çdo vlerë monetare të grumbulluar nga operatorët për shërbimet e ofruara në vitin për të cilin flasim. Kur ERRU-ja analizon nëse kostot janë mbuluar nga të ardhurat kjo gjithmonë nënkupton që të ardhurat shtesë dhe subvencionet janë marrë në konsideratë.



“Mbulimi i plotë i kostos” do të thotë që kostot e operatorit për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime mbulohen plotësisht nga faturimet/arkëtimet e shërbimeve të klientëve.

## KREU 2

### SISTEMI I TARIFAVE TË SHËRBIMEVE UJËSJELLËS-KANALIZIME DHE TARIFAT PËR SHËRBIME TË TJERA

#### Neni 2

##### Objektivat e politikës së tarifave

Operatorët zgjedhin strukturën e tarifave, duke pasur parasysh realizimin e objektivave të politikës tarifore si vijon:

a) Mbulimi i kostos. Struktura e përzgjedhur e tarifave duhet të sigurojë mbulimin e kostove të shërbimeve, nëpërmjet së cilës të ardhurat i tejkalojnë kostot. Operatorët, duhet të rrisin nivelin e arkëtimit hap pas hapi deri sa të arrihet mbulimi i plotë i kostove:

i) të ardhurat mbulojnë kostot e plota operative dhe të mirëmbajtjes;

ii) të ardhurat mbulojnë kostot operative dhe të mirëmbajtjes, si dhe amortizimin;

iii) të ardhurat mbulojnë kostot operative dhe të mirëmbajtjes, amortizimin, fondin rezervë për planin afatmesëm/afatgjatë për realizimin e shpenzimeve kapitale, si edhe shërbimin e borxhit nëse investimet janë realizuar me anë të huas.

b) Efikasiteti menaxhues. Mbulimi i kostos duhet të arrihet përmes përpjekjeve sistematike për të ulur kostot e shërbimit duke rritur efikasitetin menaxhues dhe teknik; duke ulur humbjet e ujit në sistem; duke ulur lidhjet e paligjshme; dhe duke rritur të ardhurat nëpërmjet përmirësimit të normës së arkëtimit. Vlerësimi i arritjeve në përmirësimin e performancës teknike dhe financiare të operatorëve do të shqyrtohet nga ERRU-ja përpara miratimit të ndryshimit të tarifave.

c) Përballueshmëria. Në përputhje edhe me standardet ndërkombëtare<sup>1</sup>, gjatë përcaktimit të strukturës së tarifave, ERRU-ja duhet të ketë parasysh aplikimin e një strukture tarifash të përballueshme për nevojat bazë të konsumit për

konsumatorët me të ardhura të ulëta, veçanërisht për ato zona ku skemat e subvencioneve ende nuk janë përcaktuar.

Në mënyrë që tarifat të jenë të përballueshme për konsumatorët, ERRU-ja gjatë përcaktimit të tarifave për çdo operator, mban gjithmonë parasysh që fatura e llogaritur me tarifat e reja të aprovuara nga KKRR-ja për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime, për konsumatorët familjarë në zonën e shërbimit të operatorit, nuk duhet të kalojë 5% të të ardhurave të tyre mesatare<sup>2</sup>.

d) Efikasiteti mjedisor. Struktura e tarifave duhet të përcaktojë tarifa më të larta, për konsumatorët me nivel të lartë konsumi me qëllim inkurajimin e ruajtjes së burimeve dhe një nivel konsumi të qëndrueshëm, duke pasur parasysh edhe çështjet mjedisore.

#### Neni 3

##### Elementet kryesore të politikës tarifore

1. Tarifat për shërbimet e ofruara nga operatorët (furnizimin me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura) përcaktohen mbi bazën e kostove të këtyre shërbimeve. Kostot dhe të ardhurat për secilin prej shërbimeve duhet të regjistrohen më vete. Më shumë detaje do të jepen në udhëzimin për kontabilitetin e kostos.

2. Tarifat duhet të jenë uniforme në zonën e shërbimit të operatorit. Në kushtet kur një zonë e re bëhet pjesë e zonës së shërbimit të operatorit dhe tarifat e aplikuar në këtë zonë janë më të ulëta/të larta se tarifat aktuale të operatorit, unifikimi i tarifave mund të bëhet gradualisht brenda një periudhe të caktuar (jo më shumë se tre vjet), në varësi të plotësimit të standardeve të shërbimit.

3. Konsumatorët që përfitojnë shërbimet e ofruara nga operatorët kategorizohen:

- a) familjarë;
- b) publikë;
- c) privatë;
- d) shitje uji me shumicë.

4. Në rastet kur konsumatorët janë të pajisur me matës aplikohet tarifa me dy pjesë. Komponenti fiks në një tarifë me dy pjesë përgjithësisht mbulon kostot fikse. Kurse komponenti i ndryshueshëm

<sup>1</sup> Shqipëria ka njohur zyrtarisht këto standarde të të drejtave të njeriut përmes bashkëspansorizimit të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara (UN) mbi të Drejtat e Njeriut për Ujë të Pijshëm dhe Kanalizime, në Këshillin e të Drejtave të Njeriut, më 24 mars 2011.

<sup>2</sup> Të ardhurat mesatare të konsumatorëve familjarë merret nga të dhënat e publikuara nga INSTAT-i.



përgjithësisht duhet të mbulojë kostot variabël.

5. Në rastin kur një operator i furnizimit me ujë përballet me probleme që kanë të bëjnë me cilësinë ose me sasinë e ujit, komponenti volumetrik i tarifës mund të jetë më i lartë sesa vetëm kostot variabël. Një komponent i tillë mund të stimulojë konsumatorët për të kursyer ujin.

6. Në këndvështrim afatmesëm, kostot e shërbimit të furnizimit me ujë duhet të shpërndahen ndërmjet grupeve të ndryshme të konsumatorëve, veçanërisht në rastin kur nuk ekziston një skemë subvencionesh për familjet me të ardhura të ulëta. Komponenti volumetrik i tarifës do të rritet paralelisht me rritjen e konsumit.

7. Në periudhën afatgjatë, subvencionimi i kryqëzuar ndërmjet shërbimeve apo ndërmjet kategorive të klientëve duhet të evitohet.

8. Kostot për shërbimin e largimit e përpunimit të ujërave të ndotura ndahen ndërmjet grupeve të ndryshme të konsumatorëve në bazë të volumit të ujit të konsumuar. Tarifat do të ndjekin ritëm progresiv në varësi të volumit të konsumuar dhe të shkarkuar. Për ndotësit problematikë (që shkaktojnë ndotje të rënda)<sup>3</sup> do të vihet një tarifë shtesë për ujërat e ndotura. Komponenti fiks në përgjithësi mbulon kostot fikse.

Neni 4

#### Llogaritja e kostove

1. Kostot llogariten bazuar në regjistrat kontabël të shoqërisë, të cilat janë të hartuar sipas Sistemit Kombëtar të Kontabilitetit. Për periudha afatmesme, operatorët duhet t'i llogarisin kostot nga të dhënat e kostos historike për çdo element shërbimi të marrë nga sistemi i kostos akruale<sup>4</sup> dhe nga kosto në bazë të aktivitetit<sup>5</sup>.

<sup>3</sup> Ndotës problematikë konsiderohen subjektet që shkaktojnë ndotje nga kryerja e proceseve kimike dhe teknologjike prodhimi.

<sup>4</sup> Regjistrimi kontabël sipas metodës akruale (nga anglishtja “accrual”) është një matje e performancës dhe pozicionit financiar të kompanisë që njih ngjarjen dhe aktivitetin ekonomik menjëherë (që në momentin e zotimit) pavarësisht se kur ndodh në të vërtetë transaksioni (arkëtimi ose pagesa) monetar.

<sup>5</sup> Kostot e llogaritura për çdo aktivitet (prodhim, shpërndarje, grumbullim, largim e përpunim të ujërave të ndotura).

2. Kostot fikse për leximin e matësve, faturimin, arkëtimin dhe shpenzimet administrative do të llogariten mbi bazën e kostove aktuale të secilit komponent. Kostot e përgjithshme për zyrat, administratën, shërbimet ligjore dhe personelit do të përfshihen në kostot fikse.

3. Kostot e operimit dhe mirëmbajtjes (O&M), që lidhen me vëllimin e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit, si dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura llogariten nga kostot aktuale: energji elektrike, kimikate, inventarë, shpenzime për personelin, transport etj., për të ofruar këto shërbime të konsumatorët sipas standardeve të pranueshme.

4. Kostot për blerjen e ujit me shumicë janë të përfshira në tarifën për njësi të paguar nga operatori.

5. Amortizimi do të llogaritet çdo vit.

6. Interesi për shërbimin e borxhit nëse investimet janë realizuar me anë të huas (shlyerja e principalit dhe kredisë përkatëse sipas skemës së amortizimit të rënë dakord me bankën huadhënëse) është pjesë e kostos që merret në analizë gjatë vlerësimit të tarifës.

7. Detajet do të jepen në metodologjinë për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura si edhe në udhëzimin për kontabilitetin e kostos, të miratuar nga ERRU-ja.

Neni 5

#### Struktura e tarifave dhe modeli i miratuar nga ERRU-ja

1. Struktura e tarifave përshkruan se si kosto të ndryshme të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve shpërndahen sipas kategorive të konsumatorëve. Ajo pasqyron se sa paguan (në total) secila kategori konsumatorësh për këto shërbime.

2. Struktura e tarifave mund të përdoret nga operatorët për hartimin e një strategjie për të vendosur një tarifë të përbalueshme për nevojat bazë të konsumit për familjet me të ardhura të ulëta, veçanërisht nëse nuk ekziston një skemë subvencionesh funksionale.

3. Për konsumatorët me matës, ERRU-ja do të kërkojë aplikimin e “tarifës me dy pjesë”, ku:

a) Pjesa e tarifës që mbulon kostot fikse; kjo do t'i faturohet konsumatorit nëpërmjet një komponenti mujor “tarifë fikse”;



b) Pjesa që mbulon kostot variabël: do t'i faturohet konsumatorit nëpërmjet një komponenti mujor “tarifë volumetrike”.

Tarifa me dy pjesë ndihmon për të siguruar se operatori nuk i përcakton shumë poshtë ose shumë lart kostot fikse, nëse volumet e shitjes ose lidhjet e konsumatorëve të tij janë të ndryshme nga ajo çfarë është parashikuar. Konsumi i ujit për të gjithë konsumatorët duhet të matet. Kur operatorët nuk e kanë arritur ende këtë objektiv, ata duhet të propozojnë një tarifë fikse mujore për konsumatorët pa matës (konsumatorët që nuk përdorin matës) dhe duhet të planifikojnë të kalojnë 100% në matje të konsumit. Shpjegime të detajuara në lidhje me llogaritjen e tarifës për konsumatorët me matës jepen në metodologjinë për vendosjen e tarifave.

4. Për konsumatorët pa matës duhet aplikuar një “tarifë aforfe”. Kjo tarifë duhet të përcaktohet në nivel të tillë që të stimulojë konsumatorët të pajisen me matës. Detaje të mëtejshme jepen në metodologjinë për vendosjen e tarifave.

5. Struktura e tarifave propozohet nga operatori dhe miratohet nga ERRU-ja. Propozimi për ndryshimin e tarifave për periudhën e përcaktuar në aplikimin për ndryshimin e tarifave, duhet të pasqyrojë hapat e mëposhtëm:

a) Llogaritjen e të ardhurave që nevojiten për të arritur nivelin e mbulimit të kostos sipas miratimit nga ERRU-ja;

b) Vlerësimin e një “tarifë për nevojat bazë të konsumit” për familjet me të ardhura të ulëta, në qoftë se është e aplikueshme;

c) Propozimin e strukturës tarifore për arritjen e objektivave të politikës tarifore dhe përcaktimin e komponentëve fiks dhe volumetrikë sipas llojit të konsumatorëve dhe në qoftë se kërkohet edhe niveleve të konsumit.

### KREU 3

#### PROPOZIMI PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE DHE PROCESI I MIRATIMIT TË TARIFAVE

##### Neni 6

#### Çështje të përgjithshme

1. Vetëm operatorët e licencuar mund të aplikojnë për miratim tarife.

2. Sipas ligjit nr. 8102 (i ndryshuar), neni 22, Faqe| 16936

pika 3: “Asnjë tarifë apo pjesë e saj nuk mund të modifikohet më shumë se një herë brenda vitit”.

3. Propozimi për ndryshimin e tarifave plotësohet dhe paraqitet nga operatorët duke respektuar kërkesat dhe afatet kohore të përcaktuara në ligjin nr. 8102 (i ndryshuar), si dhe në aktet nënligjore të miratuara me vendim të KKRR-së.

4. Një operator mund të aplikojë për tarifa të reja jo vetëm për një vit, por edhe për një interval kohor 2–5 vjet, nëse ka një plan biznesi afatmesëm për periudhën e kërkuar. Në këtë rast, skema e tarifave do të parashikojë një ndryshim progresiv gradual vjetor të tarifës për periudhën në shqyrtim me qëllim shmangien e rritjeve të mëdha. Ky ndryshim gradual mund të përdoret për të mbuluar ndikimet e inflacionit.

5. Në bazë të planit të biznesit, ERRU-ja është në gjendje të vendosë mbi ndryshimin gradual të tarifave, mbështetur në treguesit kryesorë të performancës të vendosur me operatorin. Rritja e tarifave lejohet vetëm me parakushtin që operatori të arrijë objektivat e performancës. Tarifat, gjithashtu, mund të ndryshohen dhe për vitin e dytë dhe/ose të tretë duke marrë parasysh diferencën ndërmjet subvencioneve të parashikuara dhe atyre të marra aktualisht për periudhën në shqyrtim.

6. ERRU-ja harton, miraton dhe informon operatorët UK në lidhje me detaje të procesit dhe procedurës së aplikimit për tarifa të reja për shërbimet: ujë i pijshëm, grumbullim, largim dhe përpunimin e ujërave të ndotura.

7. ERRU-ja përgatit gjithë dokumentacionin dhe instrumentet e nevojshme në ndihmë të operatorëve për miratimin e nivelit të tarifave për shërbimet që ofrojnë operatorët dhe i publikon, shpërndan, si edhe trajnon përdoruesit për të kontribuar në rregullimin sa më të mirë të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime.

##### Neni 7

#### Pagesa rregullatore

1. Pagesa rregullatore është detyrim vjetor për t'u paguar nga operatorët. ERRU-ja me miratimin e tarifave përcakton për çdo operator pagesën e rregullimit njofton operatorin dhe lidh kontratën me të brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Operatori duhet të kenë shlyer pagesën rregullatore të përcaktuar në kontratë përpara



paraqitjes së aplikimit për nivel të ri të tarifave për shërbimet që ai ofron.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator, çdo vit në muajin shtator, do të vendosë dhe do të publikojë përqindjen e pagesës rregullatore që do të aplikohet për vitin në vazhdim.

#### Neni 8

##### Procesi i miratimit të tarifave

1. Procedura e aplikimit fillon me paraqitjen e kërkesës nga operatori për ndryshimin e tarifave.

2. Kërkesa për ndryshim të tarifës, e paraqitur nga operatori, bazohet në analizën teknike-ekonomike (apo planin e biznesit) për shkaqet e ndryshimit të tarifave për shërbimet që ai ofron.

3. Përpara paraqitjes së aplikimit për ndryshimin e tarifave pranë Entit Rregullator, operatori bazuar në këtë analizë (plan biznesi), i paraqet kërkesën për miratimin e ndryshimit të tarifave organeve drejtuese të shoqërisë, pronarit, si dhe organizon seancën dëgjimore me publikun (bazuar në udhëzimin përkatës).

#### Neni 9

##### Dokumentacioni i aplikimit

1. ERRU-ja, bazuar në kërkesat ligjore, si dhe për të pasur një vendimmarrje sa më të drejtë në lidhje me propozimin për nivelin e ri të tarifave për shërbimet që ofrojnë operatorët përcakton dhe miraton një listë dokumentesh mbështetës.

2. Mungesa e një prej dokumenteve bën që propozimi për ndryshim tarife të mos shqyrtohet nga ERRU-ja.

3. ERRU-ja, për të analizuar dhe vlerësuar propozimin për ndryshimin e tarifave të paraqitur nga operatorët, mund të përdorë të dhëna zyrtare që lidhen me veprimtarinë e operatorëve, të grumbulluara nga institucione të tjera publike. Këto të dhëna do të përdoren, gjithashtu, për të analizuar dhe vlerësuar objektivat e performancës që janë caktuar operatorëve nga ERRU-ja.

4. ERRU-ja në bazë të ligjit nr. 8102 (i ndryshuar), kur e gjykon të arsyeshme, kryen inspektime për të verifikuar të dhënat e paraqitura nga operatori.

#### KREU 4

##### ZBATIMI DHE MONITORIMI I TARIFAVE

#### Neni 10

##### Zbatimi i tarifave

Operatori i njofton konsumatorët një muaj më parë për rritjen e tarifës. Operatori i njofton konsumatorët duke bërë njoftime në shtypin apo mediet lokale, duke përfshirë një shënim dhe në faturën e ujit të konsumatorit. Operatori, brenda orarit zyrtar të punës, vë në dispozicion të konsumatorëve dokumentacionin për tarifën aktuale. Operatori, publikon në vende të ndryshme ku ka akses publiku, vendimin për ndryshimin e tarifave, por duke mos u kufizuar vetëm në pikat ose zyrat e tij të marrëdhënieve me konsumatorin.

#### Neni 11

##### Monitorimi i zbatimit të tarifave

ERRU-ja monitoron zbatimin e tarifave të miratuara me vendim të KKRR-së. Nëse ERRU-ja konstaton se operatori zbaton një tarifë që është mbi tarifën e ndryshuar e të miratuar prej saj, do të zbatojë dënimet për kundërvajtje, të përcaktuara në nenin 32/1, pika b, të ligjit nr. 8102 (i ndryshuar). Në rast se operatori ka vënë tarifë më të lartë për konsumatorët, ai do të korrigjojë tarifën në ciklin pasues të faturimit dhe do të rimbursojë shumën e vënë mbi tarifën e rregullt të miratuar nga ERRU-ja për çdo konsumator të prekur nga aplikimi i parregullt i tarifës së ndryshuar të miratuar.

#### VENDIM

Nr. 40, datë 9.12.2015

##### **PËR MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT MBËSHTETËS PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË, LARGIMIN E PËRPUNIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA**

Në zbatim të nenit 14 dhe nenit 22, pika 1, të ligjit numër 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektori të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe në plotësim të vendimit të KKRR-së nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator



## VENDOSI:

Të miratojë dokumentacionin mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura, i detyrueshëm për t'u plotësuar nga të gjithë operatorët që ofrojnë këto shërbime, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë e pandarë e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI  
Avni Dervishi**

DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT<sup>6</sup>

1. ERRU-ja, bazuar në kërkesat ligjore, si dhe për të pasur një vendimmarrje sa më të drejtë në lidhje me propozimin për nivelin e ri të tarifave për shërbimet që ofrojnë operatorët, përcakton dhe miraton një listë dokumentesh mbështetëse.

2. Propozimi për ndryshim tarife duhet të përfshijë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Bilanci dhe pasqyrat financiare të vitit të fundit të cilit i referohemi (në rast se nuk e kanë dorëzuar përpara aplikimit siç kërkohet nga ERRU-ja), si dhe raportin e ekspertit kontabël;

- Vendimi i organit drejtues për nivelin e ri të tarifave të kërkuar nga operatori;

- Mendimi i pronarit (njësia e qeverisjes vendore) për nivelin e ri të tarifave të kërkuar nga operatori;

- Procesverbali i seancave dëgjimore me publikun;

- Raport i detajuar për gjendjen teknike dhe ekonomike të operatorit;

- Justifikimi i nivelit të ri të tarifave dhe llogaritja e tyre bazuar në modelin e llogaritjes së tarifave miratuar nga ERRU-ja;

- Subvencionet<sup>6</sup>, të cilat operatori do t'i marrë për periudhën gjatë së cilës do të aplikohen tarifat e propozuara;

- Vendimi i miratimit të Kodit të Ujit nga organi drejtues dhe operatori.

3. Mungesa e një prej dokumenteve të sipërpërmendura bën që propozimi për ndryshim tarife të mos shqyrtohet nga ERRU-ja.

4. Raporti i detajuar për gjendjen teknike dhe ekonomike i sipërpërmendur duhet të përmbajë:

a) Për sistemet e furnizimit me ujë:

- Një analizë të gjendjes aktuale të të gjitha elementeve përbërëse të tij (burimet e ujit/vepra e marrjes, stacionet e pompimit, rezervuarët e ujit, njësitë e dezinfektimit/pastrimit të ujit, linjat e dërgimit dhe rrjetet shpërndarëse).

- Informacion për problemet kryesore në lidhje me:

- operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit, humbjet e ujit, lidhjet e paligjshme, matjet;

- cilësinë e ujit të shërbyer;

- investimet e kryera në tri vitet e fundit ose që nga periudha e aprovimit të fundit të tarifave duke dhënë edhe objektet kryesore ku janë bërë këto investime, si dhe rezultatet që janë arritur në përmirësimin e shërbimit;

- strukturën organizative dhe numrin e punonjësve për këtë shërbim të shoqëruar edhe me shpjegimet përkatëse;

- zonën e shërbimit dhe popullsinë që banon në të, konsumatorëve që iu shërbehet, bazuar në të dhënat e regjistrit të konsumatorit;

- plotësimin e kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 9.1.2008, "Për tarifat e përdorimit të ujit";

- eficiencën e energjisë.

- Analizën e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera për periudhën aktuale dhe parashikimin e tyre për periudhën për të cilën kërkohet ndryshimi i tarifave.

b) Për sistemet e kanalizimeve:

- Një analizë të gjendjes aktuale të të gjitha elementeve përbërëse të tij (linjat e shkarkimit/grumbullimit të ujërave të ndotura, stacionet e pompimit, veprat e shkarkimit të ujërave të ndotura në trupat ujorë pritës, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura).

- Informacion për problemet kryesore në lidhje me:

- operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit;

- investimet e kryera në tri vitet e fundit ose që nga periudha e aprovimit të fundit të tarifave duke dhënë edhe objektet kryesore ku janë bërë këto investime, si dhe rezultatet që janë arritur në përmirësimin e shërbimit;

- strukturën organizative dhe numrin e punonjësve të këtij shërbimi të shoqëruar edhe me shpjegimet përkatëse;

<sup>6</sup> Operatorët duhet të deklarojnë shumën e subvencioneve të marra në vitin e kaluar, si dhe shumën e parashikuar për t'u marrë gjatë vitit aktual nga buxheti i shtetit. ERRU-ja do të marrë në konsideratë gjatë procesit të miratimit të tarifave subvencionin e marrë, si dhe parashikimin e subvencionit për vitin e ardhshëm.



- zonën e shërbimit dhe popullsinë që banon në të, konsumatorëve që iu shërbehet bazuar në të dhënat e regjistrit të konsumatorëve.

- Informacion i detajuar teknik në lidhje me impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura (nëse kanë) duke përfshirë të dhëna për procesin kapacitetin, eficiencën e energjisë.

- Analizën e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera për periudhën aktuale dhe parashikimin e tyre për periudhën për të cilën kërkohet ndryshimi i tarifave.

5. Për të analizuar dhe për të vlerësuar propozimin për ndryshimin e tarifave, të paraqitur nga operatorët, ERRU-ja mund të përdorë të dhëna zyrtare të grumbulluara nga institucione të tjera publike, si: Njësia e Monitorimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit; INSTAT-i; Instituti i Shëndetit Publik; laboratorët e shëndetit publik rajonal; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Mjedisit; Ministria e Financave etj. Këto të dhëna do të përdoren, gjithashtu, për të vlerësuar objektivat e performancës që u janë caktuar operatorëve nga ERRU-ja.

6. ERRU-ja, në bazë të ligjit nr. 8102 (i ndryshuar) mund të kryejë inspektime për të verifikuar të dhënat e paraqitura nga operatori.

7. Dokumentet tip janë një model i dokumenteve të kërkuara më sipër, përgatiten nga ERRU-ja dhe janë të aksesueshme në faqen zyrtare të internetit të ERRU-së.

## VENDIM

Nr. 41, datë 9.12.2015

### **PËR MIRATIMIN E PROCESIT TË MIRATIMIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË, LARGIMIN E PËRPUNIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA**

Në zbatim të nenit 14 dhe nenit 22, pika 1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe në plotësim të vendimit të KKRR-së nr. 39 datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator

## VENDOSI:

Të miratojë procesin e miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura, e detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjithë operatorët që kryejnë këto shërbime, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë e pandarë e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Avni Dervishi

## PROCESI I MIRATIMIT TË TARIFAVE

1. Procedura e aplikimit fillon me paraqitjen e kërkesës nga operatori për ndryshimin e tarifave.

2. Kërkesa për ndryshim të tarifës, e paraqitur nga operatori, bazohet në analizën tekniko-ekonomike (apo planin e biznesit) për shkaqet e ndryshimit të tarifave për shërbimet që ai ofron.

3. Përpara paraqitjes së aplikimit për ndryshimin e tarifave pranë Entit Rregullator, operatori bazuar në këtë analizë (plan biznesi), i paraqet kërkesën për miratimin e ndryshimit të tarifave organeve drejtuese të shoqërisë, pronarit, si dhe organizon seancën dëgjimore me publikun (bazuar në udhëzimin përkatës).


4. Në situata të jashtëzakonshme (siç mund të jetë rritja e çmimeve, inflacioni), që ndikojnë në mënyrë të atillë duke rritur koston totale me më shumë se 15% dhe në kushtet kur operatori duhet t’i mbulojë vetë këto kosto, operatori duhet t’i kërkojë ERRU-së rillogaritje dhe përshtatje të tarifës.

5. ERRU-ja, kur e gjykon të arsyeshme, mund t’i sugjerojë një operatori të aplikojë për ndryshimin e tarifave.

6. Skema e përgjithshme e procesit të miratimit të tarifave, ku përcaktohen hapat bazë që do të ndiqen gjatë këtij procesi, është bashkëlidhur në aneksin 1 të kësaj procedure.

7. Në mënyrë të detajuar në aneksin 2 bashkëlidhur, gjendet skema e procesit të aplikimit për tarifa të reja, ku janë përcaktuar qartë hapat dhe aktorët e përfshirë në këtë proces.


ANEKSI 1  
SKEMA E PËRGJITHSHME E PROCESTIT TË MIRATIMI TË TARIFAVE



ANEKSI 2  
SKEMA E DETAJUAR E PROCESIT TË MIRATIMIT TË TARIFAVE

## PROCESI I APLIKIMIT TE TARIFES


## Aplikimi nje ose shumevjecar





## PROCESI I APLIKIMIT TE TARIFES


### Aplikimi nje ose shumevjecar





## PROCESI I APLIKIMIT TE TARIFES


### Aplikimi nje ose shumevjecar





## PROCESI I APLIKIMIT TE TARIFES

### Aplikimi nje ose shumevjecar






## PROCESI I APLIKIMIT TE TARIFES

### Aplikimi nje ose shumevjecar

FAZA VI

10 ditë  
punë

**VENDIM****Nr. 42, datë 9.12.2015****PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË  
PËR VENDOSJEN E TARIFAVE PËR  
SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË  
DHE LARGIMIN E PËRPUNIMIN E  
UJËRAVE TË NDOTURA**

Në zbatim të nenit 14 dhe nenit 22, pika 1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe në plotësim të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Të miratojë metodologjinë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura, e detyrueshme të zbatohet nga të gjithë operatorët që ofrojnë këto shërbime, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë e pandarë e tij.

2. Nivel i tarifës bazohet në “Politikën tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe përcaktohet sipas metodologjisë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, miratuar nga Enti Rregullator i Ujit.

3. Bazë për vlerësimin e aplikimit për nivelin e tarifës së shërbimeve ujësjellës-kanalizime është metodologjia “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, si dhe “Justifikimi i nivelit të kërkuar të tarifës - Modeli i aplikimit”, të cilat përgatiten sipas një procesi, manualeve përkatëse për përdoruesit dhe dokumenteve tip të përgatitura dhe vënë në dispozicion për operatorët nga Enti Rregullator i Ujit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI  
Avni Dervishi**

**METODOLOGJIA****PËR VENDOSJEN E TARIFAVE PËR  
SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIN E PËRPUNIMIN E UJËRAVE TË  
NDOTURA**

Metodologjia e llogaritjes së tarifave për shërbimet ujë i pijshëm, grumbullim, largim dhe trajtim i ujërave të ndotura është një dokument që synon lehtësimin e vendosjes së tarifave të shërbimeve në këtë sektor. Ky dokument përmirësohet për aq sa konsiderohet e nevojshme nga ana e rregullatorit dhe komunikohet me operatorët në lidhje me ndryshimet e bëra.

ERRU-ja angazhohet të zbatojë drejt dhe saktë metodologjinë dhe të kontribuojë në trajnimin e operatorëve në lidhje me përdorimin e kësaj metodologjie. Fryma e saj është ajo e vënies në jetë të politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, miratuar me vendim të KKRR-së.

**KREU I****METODOLOGJIA PËR VENDOSJEN E  
TARIFAVE PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E  
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA****Neni 1****Përkufizime**

“Enti Rregullator i Ujit (ERRU)” është institucioni i pavarur që rregullon sektorin e furnizimit me ujë, të largimit dhe të përpunimit të ujërave të ndotura në përputhje me ligjin nr. 8102 (i ndryshuar).

“Komisioni” është Komisioni Kombëtar Rregullator që udhëheq Entin Rregullator të Ujit që funksionon në bazë të ligjit nr. 8102 (i ndryshuar).

“Zona e juridiksionit” është zona, ku operatori i licencuar është përgjegjës të ofrojë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

“Sistemi i furnizimit me ujë” përbëhet nga tërësia e elementeve, si: vepra e marrjes, sistemi i pompave, njësitë e dezinfektimit, rezervuarët, linjat e transmetimit dhe rrjeti shpërndarës.

“Sistemi i kanalizimeve” është sistemi që përbëhet nga tërësia e elementeve, si linjat e shkarkimit/grumbullimit të ujërave të ndotura, linjat e largimit dhe/ose stacionet e pompimit të ujërave të ndotura, veprat e shkarkimit të tyre në trupat ujorë pritës, si dhe impiantet e trajtimit të



ujërave të ndotura (nëse sistemi është i pajisur me to).

“Shërbimet UK” është tërësia e shërbimeve të kryera nga operatorët të konsumatorët përmes sistemeve të furnizimit me ujë, si dhe sistemeve të grumbullimit, largimit dhe/ose trajtimit të ujërave të ndotura.

“Konsumatorë” janë të gjitha kategoritë familjare, publike dhe privat, të cilët përdorin shërbimet e furnizimit me ujë dhe/ose kanalizimeve.

“Konsumator familjar” nënkupton konsumatorin që përfiton shërbimet e ofruara nga operatori në objektin e banimit për nevoja jetësore (gatim, shërbime sanitare etj.).

“Konsumator publik” nënkupton çdo person/subjekt ligjor të klasifikuar si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare (ambasada, konsullata dhe rezidenca diplomatike), selitë e partive politike dhe degëve të tyre, si dhe çdo institucion i cili kryen aktivitet me interes të përbashkët ose publik që nuk është regjistruar si organizatë fitimprurëse.

“Ente private” nënkupton çdo person/subjekt ligjor ose organizatë fitimprurëse që ushtron veprimtari tregtare apo industriale të çfarëdolloji, përfshirë edhe shoqëritë tregtare shtetërore (KESH sh.a., ndërmarrjet e trajtimit të studentëve e tjera të ngjashme).

“Operator” është subjekti i licencuar nga ERRU-ja që ushtron aktivitetet e shërbimit të furnizimit me ujë, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura dhe ofron një ose disa nga këto shërbime sipas kategorive të përcaktuara në licencë.

“Sistemi i tarifave” nënkupton parametrat, kriteret dhe standardet e përdorura për përcaktimin e tarifës për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime për kategori të ndryshme konsumatorësh dhe nivele të ndryshme konsumi.

“Faktorët e strukturës së tarifës” i referohen peshës relative të tarifës së dhënë për njësinë e volumit të konsumit të ujit ndërmjet grupeve të ndryshme të konsumatorëve dhe niveleve të ndryshme të konsumit.

“Tarifa e ujit” është çmimi që konsumatorët duhet të paguajnë për shërbimin e furnizimit me ujë, të ofruar nga operatorët nëpërmjet rrjetit shpërndarës. I njëjti term përdoret zakonisht edhe për tarifën e kanalizimeve (largimin e përpunimit e ujërave të ndotura). Tarifa e ujit të pijshëm dhe

kanalizimeve vendosen për të mbuluar koston e prodhimit, trajtimit të ujit, depozitimin dhe shpërndarjes së tij të konsumatorët, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, si edhe faturimin dhe mbledhjen e të ardhurave nga këto shërbime.

“Tarifa me dy pjesë” përbëhet nga komponenti volumetrik dhe nga komponenti fiks i tarifës. Komponenti volumetrik përcaktohet si çmim/m<sup>3</sup>. Komponenti fiks i tarifës është një çmim fiks në vit ose në muaj. Tarifa me dy pjesë mund të aplikohet vetëm në rastet kur matësit janë të instaluar dhe lexohen. Përndryshe aplikohet një “tarifë aforfe”.

“Tarifë për shërbime të tjera” është termi i përdorur për të gjitha shërbimet e tjera të ofruara nga operatori, të cilat nuk janë pjesë e faturimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, por që duhet të paguhet nga konsumatori.

“Shitja e ujit me shumicë” është situata në të cilën uji shitet te një blerës nga një ose disa pika shpërndarjeje me qëllimin e rishitjes së tij për konsumatorët individualë brenda zonës së shërbimit të blerësit me shumicë.

“Tarifë mesatare” është mesatarja që rezulton nga totali i të ardhurave sipas volumit të faturuar me tarifë të kombinuara (tarifë volumetrike + tarifë fikse/tarifë e sheshtë), mbi totalin e volumit të faturuar, për një afat kohor (muaj/tremujor ose vit).

“Të ardhurat” nënkuptojnë çdo vlerë monetare të grumbulluar nga operatorët për shërbimet e ofruara në vitin për të cilin flasim. Kur ERRU-ja analizon nëse kostot janë mbuluar nga të ardhurat kjo gjithmonë nënkupton që të ardhurat shtesë dhe subvencionet janë marrë në konsideratë.

“Mbulimi i plotë i kostos” do të thotë që të ardhurat nga faturimi i shërbimeve të ofruara nga operatori të mbulojnë kostot për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime mbulohen.

## Neni 2

### Çështje të përgjithshme

1. Propozimi për ndryshimin e tarifave plotësohet dhe paraqitet nga operatorët duke respektuar kërkesat dhe afatet kohore të përcaktuara në ligjin nr. 8102 (i ndryshuar), si dhe në aktet nënligjore të miratuara me vendim të KKRR-së.

2. Propozimi për ndryshimin e tarifave paraqitet nga operatorët pas përfundimit të bilancit financiar



vjetor. Gjithashtu, propozimi për ndryshimin tarife kërkon informacion për të gjitha subvencionet që do të përfitohen për periudhën në vijim.

2. Aplikimet për ndryshimin e tarifave për vitin pasues paraqiten pranë ERRU-së brenda gjashtëmujorit të parë të vitit aktual. Çdo propozim i paraqitur pasi ka kaluar afati duhet të riparaqitet në vitin e ardhshëm me shifra të përditësuara.

4. Në rast se dokumentacioni i aplikimit nuk është plotësuar sipas kërkesave të vendimit nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura” ose operatori nuk arrin të transferojë pagesën rregullatore në llogarinë e ERRU-së sipas afatit të përcaktuar në kontratën e mëparshme, aplikimi për ndryshimin e tarifave riparaqitet në vitin e ardhshëm me shifra të përditësuara.

5. E njëjta procedurë ndiqet edhe kur ERRU-ja përcakton afat kohor për qartësimin ose plotësimin e informacionit dhe operatori nuk e respekton atë.

#### Neni 3

##### Pagesa rregullatore

1. Pagesa rregullatore është detyrim vjetor për t’u paguar nga operatorët. ERRU-ja, me miratimin e tarifave, përcakton për çdo operator pagesën e rregullimit njofton operatorin dhe lidh kontratën me të brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Operatori duhet të kenë shlyer pagesën rregullatore të përcaktuar në kontratë përpara paraqitjes së aplikimit për nivel të ri të tarifave për shërbimet që ai ofron.

2. Pagesa rregullatore përllogaritet mbi të ardhurat vjetore të parashikuara nga aktiviteti (bazuar në volumet e parashikuara në aplikim me tarifën e miratuar nga ERRU-ja) dhe do të jetë e ndryshme:

- për operatorët që mbulojnë deri në 50% të kostos totale;
- për operatorët që mbulojnë më shumë se 50% të kostos totale.

3. Komisioni Kombëtar Rregullator, çdo vit në muajin shtator do të vendosë dhe do të publikojë përqindjen e pagesës rregullatore që do të aplikohet për vitin në vazhdim.

#### KREU 2

##### SISTEMI I TARIFAVE TË SHËRBIMEVE UK DHE TARIFAT PËR SHËRBIME TË TJERA

#### Neni 4

##### Metodologjia e vendosjes së tarifave

1. Metodologjia e vendosjes së tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura bazohet në katër objektivat e politikës së tarifave:

a) Mbulimi i kostove: fillimisht mbulimi i kostove për operim dhe mirëmbajtje e më tej hap pas hapi deri në mbulimin e të gjitha kostove të operatorit që lidhen me realizimin e aktivitetit të tij për ofrimin e shërbimeve përkatëse;

b) Efikasitetin menaxhues;

c) Përballeshmërinë e saj nga konsumatorët në nevojë; dhe

d) Efikasitetin mjedisor.

2. Tarifa për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura përcaktohet sipas kategorive të konsumatorëve, sikurse përcaktohet në nenin 3 të dokumentit të politikës tarifore:

a) familjarë;

b) publikë;

c) privatë;

d) shitje uji me shumicë.

3. Struktura e tarifës ndjek logjikën e matjes ose jo të konsumit, sikurse përcaktohet në nenin 5, të dokumentit të politikës tarifore.

#### Neni 5

##### Llogaritja e kostove

1. Vlerësimi i nivelit të tarifave të shërbimeve nis me llogaritjen e kostove për realizimin e shërbimeve përkatëse. Për periudha afatmesme, operatorët duhet t’i llogarisin kostot nga të dhënat e kostos historike për çdo element shërbimi të marrë nga sistemi i kostos aktuale<sup>7</sup> dhe nga kosto në bazë të aktivitetit<sup>8</sup>.

2. Kostot fikse për leximin e matësve, faturimin, arkëtimin dhe shpenzimet administrative do të llogariten mbi bazën e kostove aktuale të secilit

<sup>7</sup> Kostot e një shërbimi në një periudhë të caktuar, por me likuidim të mëvonshëm.

<sup>8</sup> Kostot e llogaritura për çdo aktivitet (prodhim, shpërndarje, grumbullim, largim e përpunim të ujërave të ndotura).



komponent. Kostot e përgjithshme për zyrat, administratën, shërbimet ligjore dhe personelit do të përfshihen në kostot fikse.

3. Kostot e operimit dhe mirëmbajtjes (O&M) që lidhen me vëllimin e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit, si dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura llogariten nga kostot korrente: energji elektrike, kimikate, inventarë, shpenzime për personelin, transport etj., për të ofruar këto shërbime të konsumatorët sipas standardeve të pranueshme.

4. Kostot për blerjen e ujit me shumicë janë të përfshira në tarifën për njësi të paguar nga operatori.

5. Amortizimi do të llogaritet çdo vit.

6. Interesi për shërbimin e borxhit nëse investimet janë realizuar me anë të huas, është pjesë e kostos që merret në analizë gjatë vlerësimit të tarifës.

7. Kur operatori ofron si shërbimin e furnizimit me ujë, atë të kanalizimeve kostoja dhe të ardhurat e shërbimit të kanalizimeve duhet të llogariten veç nga kostoja dhe të ardhurat e shërbimit të furnizimit me ujë. E njëjta procedurë do të ndiqet dhe në rastet kur operatori ofron shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura. Kur operatori ofron si shërbimin e furnizimit me ujë, të kanalizimeve apo dhe të trajtimit të ujërave të ndotura, kostot administrative dhe të përgjithshme ndahen ndërmjet shërbimeve në mënyrë proporcionale, në mënyrë që shuma e përgjithshme të mos ndryshojë.

#### Neni 6

### Rritja e tarifave bllok për konsumatorët me matës uji

1. Në rastet kur konsumatorët janë të pajisur me matës aplikohet tarifa me dy pjesë. Komponenti fiks në një tarifë me dy pjesë përgjithësisht mbulon kostot fikse. Kurse komponenti i ndryshueshëm (volumetrik), përgjithësisht duhet të mbulojë kostot variabël. Komponenti volumetrik i tarifës do të rritet paralelisht me rritjen e konsumit.

2. ERRU-ja inkurajon operatorët të propozojnë një tarifë bllok në rritje për konsumatorët me matës uji, ku aplikohen tarifa më të larta për konsumatorët që konsumojnë përtej volumit të kufirit minimal (për shembull 4.5 m<sup>3</sup>/muaj). Sipas “ritjes së tarifës bllok”, tarifa për njësi për ujin e konsumuar duhet të jetë më e ulët për bllokun e

parë të konsumit dhe në rritje për bllokun e dytë dhe për blloqet e tjera pasuese, nëse do të ketë. Në mënyrë që të mënjanohej tarifat e padrejta, operatori duhet të ndajë lidhjet ekzistuese të përbashkëta. Lidhjet e përbashkëta duhet të zëvendësohen nga lidhje individuale me matës uji.

3. Në qoftë se operatorët kanë vendosur të aplikojnë strukturën e tarifës bllok, operatorët propozojnë struktura tarifore për blloqet e konsumit për kategoritë e ndryshme të konsumatorëve. Tarifat për blloqet e ndryshme të konsumit në tri kategoritë e ndryshme të konsumatorëve duhet të jenë brenda kufijve të pranueshme të faktorëve të strukturës së tarifave të dhëna më poshtë. Këta kufij për tarifat e mundshme janë përcaktuar duke marrë parasysh strukturat shumë të ndryshme të operatorëve.

Faktorët e strukturës së tarifave për blloqe të ndryshme të konsumit dhe kategori konsumatorësh

| Kategoria e konsumatorëve | Blloqet e strukturave të tarifave (metra kub/muaj) |              |              |               |
|---------------------------|----------------------------------------------------|--------------|--------------|---------------|
|                           | <4.5                                               | 4.5 deri 20  | 20 deri 30   | > 30          |
| Familjarë                 | 1.0*                                               | 1.0 deri 3.0 | 1.5 deri 4.0 | 2.5 deri 6.0  |
| Publikë                   | 1.0 deri 2.0                                       | 1.0 deri 3.0 | 1.5 deri 5.0 | 2.5 deri 10.0 |
| Privatë                   | 1.0 deri 2.0                                       | 1.5 deri 4.0 | 2.0 deri 6.0 | 3.0 deri 12.0 |

\*faktor = herë

Shembull. Për kategorinë e konsumatorëve familjarë, tarifa/m<sup>3</sup> ujë të konsumuar, për nivelet më të larta të konsumit mund të jetë deri në gjashtë herë më e madhe se tarifa në nivelet më të ulëta të konsumit. Po ashtu, për konsumatorët privatë/industrialë mund të ketë tarifë më të lartë se konsumatorët familjarë.

Rritja e tarifës bllok është veçanërisht e përshtatshme për zonat ku nuk aplikohet një skemë subvencionimi e konsumit të ujit të pijshëm dhe shërbimit të kanalizimeve për familjet në nevojë. Për konsum deri në 4.5 m<sup>3</sup> për familje/muaj do të faturohet një përqindje më e ulët e tarifës mesatare.

4. Në qoftë se është zgjedhur aplikimi i një tarife bllok, operatori duhet të jetë i kujdesshëm të mos aplikojë tarifa të larta për një grup të caktuar konsumatorësh që i detyrojnë ata të gjejnë burime shtesë furnizimi ose të anulojnë kontratën. Në këtë rast, mund të merret parasysh edhe tarifa me dy pjesë e unifikuar.

5. Për konsumatorët pa matës aplikohet një tarifë aforfe. Kjo tarifë duhet të përcaktohet në nivel të tillë që të stimulojë konsumatorët të pajisen me matës.



## Neni 7

**Tarifa për shitje uji me shumicë**

1. Tarifa e shitjes së ujit me shumicë mbulon koston e këtij shërbimi dhe një përfitim të mundshëm (maksimumi 5%).

2. Çdo operator që aplikon për miratim tarifë shitje me shumicë duhet të paraqitë pranë ERRU-së kërkesën e saj të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- relacion shpjegues (argumenti i kërkesës për shitje uji me shumicë);
- miratimin e tarifës së kërkuar nga organet drejtuese;
- llogaritja e tarifës së shitjes së ujit me shumicë;
- aktmarrëveshjen ndërmjet palëve.

3. Operatori (shitësi) duhet t'i paraqesë ERRU-së marrëveshjen me blerësin. Nëse nevojiten ndryshime, ERRU-ja informon operatorin dhe blerësin për to. Nëse ERRU-ja nuk përgjigjet brenda 30 ditësh, palët e mësipërme mund ta konsiderojnë mos përgjigjen si miratim formal. Në çdo rast, ERRU-ja duhet të miratojë tarifat e shitjes së ujit me shumicë.

## Neni 8

**Tarifa e shërbimit për grumbullimin, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura**

1. Kostot për shërbimin e largimit të përpunimit të ujërave të ndotura ndahen ndërmjet grupeve të ndryshme të konsumatorëve në bazë të volumit të ujit të konsumuar. Tarifat do të ndjekin ritëm progresiv në varësi të volumit të shkarkuar. Komponenti fiks në përgjithësi mbulon kostot fikse.

2. Kur operatori ofron shërbimin e grumbullimit, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura kostoja dhe të ardhurat për shërbimin e grumbullimit dhe largimin të ujërave të ndotura duhet të llogariten veç nga kostoja dhe të ardhurat për shërbimin e përpunimit të ujërave të ndotura.

3. Kur operatori ofron si shërbimin e furnizimit me ujë dhe atë të kanalizimeve (grumbullimit, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura), kostot administrative dhe të përgjithshme ndahen ndërmjet këtyre shërbimeve në mënyrë proporcionale, në mënyrë që shuma e përgjithshme të mos ndryshojë.

4. Kostot e shërbimit për grumbullimin, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura

lidhen me sasinë e ujërave të ndotura të shkarkuara për çdo konsumator. Sasia e ujërave të ndotura do të merret 100% e sasisë së ujit të konsumuar.

5. Në rast se konsumatori furnizohet me ujë nga një pus ose burime të tjera dhe operatori i ofron shërbimin me kanalizime mund të aplikohet një tarifë fikse për kanalizimet.

6. Për konsumatorët që shkaktojnë ndotje problematike (të rënda) operatori mund të vendosë tarifa të posaçme (p.sh. mund të vendosen tarifa të veçanta për higjienën në terren). Ato duhet të mbulojnë kostot reale.

## Neni 9

**Tarifat për shërbime të tjera**

1. Operatorët kryejnë edhe disa shërbime të tjera, të cilat kanë koston e tyre që duhet të mbulohet nga konsumatorët, siç janë: tarifë lidhje, tarifë rilidhje, tarifë për instalimin e matësit etj.

2. Të gjitha tarifat e mësipërme duhet të përfshihen në propozimin për ndryshimin e tarifave. ERRU-ja do të analizojë nëse tarifat për shërbimet e tjera janë të arsyeshme krahasuar me kostot e operatorit. Nëse gjykohet se tarifat nuk janë të arsyeshme, ERRU-ja do të bëjë rekomandime për përmirësime tek organet drejtuese dhe operatori.

## KREU 3

**VLERËSIMI I PROPOZIMIT PËR NDRYSHIM TARIFFE**

## Neni 10

**Procesi i miratimit të tarifave**

1. Procesi i aplikimit dhe i miratimit të tarifave, ashtu sikurse përcaktohet në dokumentin e politikës së tarifës fillon kryesisht nga nevoja e operatorit për të mbuluar nivelin e ri të kostove të shërbimeve që ofron. Në mënyrë të detajuar ky proces është paraqitur në një dokument të veçantë të miratuar nga ERRU-ja me vendim të KKRR-së nr. 41, datë 9.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura".

## Neni 11

**Dokumentacioni i aplikimit**

1. Operatori është i detyruar që në momentin e aplikimit të dorëzojë pranë ERRU-së dokumentacionin e nevojshëm, përcaktuar sipas vendimit të


KKRR-së nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura”, që i jep mundësi rregullatorit për të krijuar një gjykim të drejtë në lidhje me nivelin e tarifave të reja.

Neni 12

### Vlerësimi i propozimit për ndryshim tarife Vështirësi i përgjithshëm

1. Analiza e propozimit të tarifave kryhet sipas strukturës në skemën e mëposhtme. Kjo analizë fillon me shqyrtimin e “Kostot e parashikuara të

operimit dhe mirëmbajtjes” dhe të treguesve të performancës të paraqitura nga operatori. Zbriten kostot e papranueshme dhe korrigjohen treguesit e performancës mbi bazën e analizës së tyre. Rezultati është “Kostot e ndryshuara të performancës të O&M” dhe “treguesit e ndryshuar të performancës”, të cilat ERRU-ja i njeh për të përcaktuar tarifën mesatare. Kategoritë e ndryshme të tarifave rrjedhin nga tarifa mesatare, duke marrë parasysh vëllim/mënyrën e faturimit. Skema e mëposhtme jep vetëm një ide të përgjithshme, ndërsa detajet shpjegohen në nenet në vazhdim.



Neni 13

### Vlerësimi i propozimit për ndryshim tarife Analiza e koston

1. ERRU-ja propozon për shpenzimet O&M “të arsyeshme dhe të nevojshme” për ofrimin e shërbimeve eficiente. ERRU-ja analizon kosto të veçanta të operatorit. Kjo bëhet për të siguruar që konsumatorët të paguajnë vetëm kosto të justifikuar.

2. ERRU-ja, jo vetëm i analizon kostot e operatorit, por edhe i krahason ato me kostot e operatorëve të tjerë të ngjashëm. Arsyet e uljeve duhet të shpjegohen qartë. Nëse shpjegimet e dhëna nga operatori nuk justifikojnë nivelin e rritjes së shpenzimeve, ERRU-ja propozon ulje të kostove të parashikuara.

3. Në raste të caktuara, ERRU-ja mund “të përshpejtojë” procesin e aplikimit për tarifa. “Përshpejtimi” do të thotë se ERRU-ja do të thjeshtojë këtë proces dhe ushtron më pak kontroll mbi zëra specifikë të shpenzimeve. Operatorët që kanë të drejtë të jenë objekt i shqyrtimit të shpejtë mund të jenë operatorët me skema të vogla shërbimi dhe operatorët që i plotësojnë ose i tejkalojnë objektivat e performancës. “Përshpejtimi” është kompetencë e ERRU-së.

Neni 14

### Vlerësimi për propozim ndryshimi tarife Analiza e performancës

1. Analiza e performancës përqendrohet në tregues të caktuar për të përcaktuar nëse ka



devijime nga performanca për të cilën është rënë dakord. Këta tregues janë:

1) Uji pa të ardhura (humbjet), e cila është ndarë në dy nëngrupe:

- a) humbje administrative;
- b) humbje teknike.

2) Niveli i matjes, i cili është ndarë në dy nëngrupe:

- a) niveli i matjes për klientët familjare;
- b) niveli i matjes për klientët jofamiljarë (institucione buxhetore & ente private).

3) Cilësia e ujit, e ndarë në dy nëngrupe:

- a) niveli i klorit mbetës;
- b) niveli i koliformit.

4) Kohëzgjatja e furnizimit me ujë (orët e shërbimit).

5) Përdorimi efikas i energjisë i ndarë në tri grupe sipas shërbimit që ofrohet.

6) Efikasiteti i stafit (stafi/1,000 lidhje).

7) Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë.

8) Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve.

9) Perceptimi i rregullatorit<sup>9</sup>.

10) Përpjekje dhe masa të veçanta për përmirësimin e efikasitetit, shërbimit ose performancës.

11. Norma e arkëtimit<sup>10</sup>.

2. Për treguesit 1–9 dhe 11, operatorët përcaktojnë tregues të ndryshëm krahasimi. Treguesi 10 është tregues cilësor, me anë të të cilit operatori mund të “shpërblehet” për iniciativat e veçanta që tregojnë angazhimin e tyre për performancë të mirë.

3. Tabela më poshtë tregon mënyrën sesi llogaritet vlerësimi i performancës:

| Pikët sipas objektivave                                             | Min | Max |
|---------------------------------------------------------------------|-----|-----|
| 1. Uji pa të ardhura (humbjet)                                      |     |     |
| a) humbjet administrative                                           | -15 | +7  |
| b) humbjet teknike                                                  | -5  | +3  |
| 2. Niveli i matjes                                                  |     |     |
| a) niveli i matjes për klientët familjare                           | -5  | +3  |
| b) niveli i matjes për klientët jofamiljarë (institucione buxhetore | -15 | +7  |

<sup>9</sup> Objektivi i performancës, perceptimi i rregullatorit, do të vlerësohet në mënyrë transparente, që do të përfshijë elemente, si koha e reagimit dhe përgjigjja e operatorëve ndaj kërkesave të ERRU-së, likuidimin në kohë i pagesave rregullatore etj.

<sup>10</sup> Objektivi 11 (norma e arkëtimit) do të përdoret në nenin 19.

|                                                                                               |             |             |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|-------------|
| & ente private)                                                                               |             |             |
| 3. Cilësia e ujit                                                                             | -15         | +7.5        |
| 4. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë (orët e shërbimit)                                         | -15         | +7.5        |
| 5. Efikasiteti i përdorimit të energjisë                                                      | -20         | +10         |
| 6. Efikasiteti i stafit (stafi/1,000 lidhje)                                                  | -20         | +10         |
| 7. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë                                                   | -15         | +7.5        |
| 8. Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve                                                        | -15         | +7.5        |
| 9. Perceptimi për rregullatorin                                                               | -10         | +5          |
| <b>Shuma e pikëve</b>                                                                         | <b>-150</b> | <b>+75</b>  |
| <b>Bonusi</b>                                                                                 |             |             |
| 10. Përpjekje dhe masa të veçanta për përmirësimin e efikasitetit, shërbimit ose performancës | 0           | +75         |
| <b>Totali i përgjithshëm i pikëve</b>                                                         | <b>-150</b> | <b>+150</b> |

4. Mosrealizimi nga një operator i treguesve dhe standardeve të përcaktuara (treguesit 1–9) ka ndikim negativ dhe do të çojë në një ulje të vlerësimit të performancës. Në rast se operatori i arrin objektivat e caktuar për këta tregues, nuk do të ketë as ulje dhe as bonus, por 0 pikë.

5. Në rastin kur operatori i tejkalon objektivat për treguesit 1–9 do të jepet një bonus pikësh. Pikët bonus do të jepen sipas shkallës së tejkalimit të objektivave (deri në maksimumin e shumës së treguar në tabelë).

6. ERRU-ja do të marrë në konsideratë akordimin e një bonusi shtesë për përpjekje të jashtëzakonshme dhe iniciativave për të përmirësuar eficiencën, shërbimin apo furnizimin me ujë (treguesi 10). Arsyeja për dhënien e një bonusi të veçantë ndërmjet 1–75 pikëve do të përcaktohet në vendimin e komisionit (paraprak dhe final).

7. Rezultati përgjithshëm më pas transformohet në të dhëna monetare si përqindje e kostove të ndryshuara (shih nenin 18). Shpërblimi/penalizmi maksimal shkon deri në +/-5% të kostove të ndryshuara për operatorët e tipit I (kostot e O&M-së nuk janë mbuluar ende) dhe +/-10% të kostove të ndryshuara për tipin II të operatorëve (> se 100% mbulim i kostove O&M).



Tabela më poshtë tregon shumat ekzakte sipas performancës:

| Rezultati i përgjithshëm* | Performanca Ndryshimi tipi I | Performanca Ndryshimi tipi II |
|---------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| 150                       | 5%                           | 10%                           |
| 140                       | 4,67%                        | 9,33%                         |
| 130                       | 4,33%                        | 8,67%                         |
| 120                       | 4,00%                        | 8,00%                         |
| 110                       | 3,67%                        | 7,33%                         |
| 100                       | 3,33%                        | 6,67%                         |
| 90                        | 3,00%                        | 6,00%                         |
| 80                        | 2,67%                        | 5,33%                         |
| 70                        | 2,33%                        | 4,67%                         |
| 60                        | 2,00%                        | 4,00%                         |
| 50                        | 1,67%                        | 3,33%                         |
| 40                        | 1,33%                        | 2,67%                         |
| 30                        | 1,00%                        | 2,00%                         |
| 20                        | 0,67%                        | 1,33%                         |
| 10                        | 0,33%                        | 0,67%                         |
| 0                         | 0,00%                        | 0,00%                         |
| -10                       | -0,33%                       | -0,67%                        |
| -20                       | -0,67%                       | -1,33%                        |
| -30                       | -1,00%                       | -2,00%                        |
| -40                       | -1,33%                       | -2,67%                        |
| -50                       | -1,67%                       | -3,33%                        |
| -60                       | -2,00%                       | -4,00%                        |
| -70                       | -2,33%                       | -4,67%                        |
| -80                       | -2,67%                       | -5,33%                        |
| -90                       | -3,00%                       | -6,00%                        |
| -100                      | -3,33%                       | -6,67%                        |
| -110                      | -3,67%                       | -7,33%                        |
| -120                      | -4,00%                       | -8,00%                        |
| -130                      | -4,33%                       | -8,67%                        |
| -140                      | -4,67%                       | -9,33%                        |
| -150                      | -5,00%                       | -10,00%                       |

\*Rezultati i përgjithshëm rrumbullakohet në dhjetëshen e sipërme ose të poshtme.

Kostot e ndryshuara të ponderuara të performancës përmbajnë penalitet/shpërblimet, si dhe ndryshimet për kostot e pajustificuara. Kostot e ndryshuara të ponderuara të performancës së operimit dhe mirëmbajtjes janë kostot që ERRU-ja u lejon operatorëve t'i marrin parasysh. Nëse operatori nuk punon mirë, ai do të haset me një deficit. Në të kundërt, ai do të ketë përfitim.

Neni 15

#### Vlerësimi i propozimit për ndryshim tarife Tarifa mesatare

1. Në llogaritjen e tarifës mesatare merret parasysh kriteri i eficiencës “norma e arkëtimit” (11). Duke aplikuar parametrat e rënë dakord për çdo kriter në llogaritje, siç jepet më poshtë,

operatorët penalizohen automatikisht nëse nuk i arrijnë objektivat e përcaktuar ose do të shpërblehen në qoftë se i tejkalojnë ata.

2. Llogaritjet e mëposhtme tregojnë si nxirret tarifa mesatare (duke përfshirë normën e arkëtimit):

|                                                        |
|--------------------------------------------------------|
| <b>Kostot e ndryshuara të performancës</b>             |
| / Sasia e parashikuar për faturim (në m <sup>3</sup> ) |
| = Kostoja mesatare e parashikuar (për m <sup>3</sup> ) |

|                                                                                                                                                                                 |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| $\text{Kostoja mesatare e parashikuar (për m}^3\text{)} = \frac{\text{Tarifa mesatare e parashikuar (për m}^3\text{)}}{\text{Sasia e parashikuar për faturim (në m}^3\text{)}}$ |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

3. Norma e arkëtimit dhe përcaktimi i tarifës mesatare. Ndërsa ekuacioni “Kostoja mesatare e parashikuar (për m<sup>3</sup>) = Tarifa mesatare e parashikuar (për m<sup>3</sup>)” është përgjithësisht detyruese, nënkupton që norma e arkëtimit është 100%. Gjithsesi, pranohet se pjesa më e madhe e operatorëve nuk do të jetë në gjendje të mbledhin 100% të shumës së faturuar. Do të përcaktohen stimuj me qëllim rritjen e vazhdueshme të normës së arkëtimit.

Si rezultat, treguesit e mëposhtëm të krahasimit do të përcaktohen duke marrë parasysh nivelet aktuale të çdo operatori individual. Më pas, ky tregues përdoret për të llogaritur tarifën mesatare të ndryshuar, duke përfshirë dhe normën e arkëtimit.

Shembull. Nëse tarifa mesatare e parashikuar (duke përjashtuar normën e arkëtimit) është 100 ALL dhe norma e arkëtimit sipas *benchmarking* është 85%, tarifa mesatare do të jetë:

$$100 / (85 / 100) = 100 / 0,85 = 117,65 \text{ ALL.}$$

Neni 16

#### Vlerësimi i propozimit për ndryshim tarife Periudha tranzitore

1. Tarifat duhet të jenë uniforme në zonën e shërbimit të operatorit. Në kushtet kur një zonë e re bëhet pjesë e zonës së shërbimit të operatorit dhe tarifat e aplikuara në këtë zonë janë më të ulëta/të larta se tarifat aktuale të operatorit, unifikimi i tarifave mund të bëhet gradualisht brenda një periudhe të caktuar (jo më shumë se tre vjet), në varësi të plotësimit të standardeve të shërbimit.

2. Për propozimin e parë për ndryshimin e tarifës, brenda periudhës tranzitore, për rastet



kur shtohet një zonë e re si pjesë e zonës së shërbimit të operatorit, sipas kësaj metodologjie do të bëhet vetëm analiza e kostos. Më tej, ERRU-ja do të përcaktojë një grup treguesish bazë performance për çdo operator, të cilët do të vlerësohen gjatë ndryshimeve të tarifave në periudhat në vazhdim.

#### KREU 4

#### ZBATIMI DHE MONITORIMI I TARIFAVE

##### Neni 17

##### Zbatimi i tarifave

1. ERRU-ja, bazuar në vlerësimin e gjithë dokumentacionit mbështetës dhe nëse është parë e arsyeshme inspektimeve pranë operatorit aplikues, miraton nivelet e reja të tarifave të shërbimeve për të cilat janë plotësuar të gjitha kriteret e vlerësimit.

2. ERRU-ja, njofton operatorin, organet drejtuese të tij, si dhe pronarin në lidhje me vendimin e tij duke e shoqëruar me një dokument të detajuar që shpjegon qëndrimin e rregullatorit.

3. Nëse vendimi i rregullatorit është miratimi i një niveli të ri tarifash, ERRU-ja lidh një kontratë të re tarifash me operatorin, duke specifikuar saktë nivelet e reja të tarifave që duhet të aplikohen nga operatori në fjalë.

4. Operatori i njofton konsumatorët një muaj më parë për rritjen e tarifës. Operatori i njofton konsumatorët duke bërë njoftime në shtypin apo mediat lokale, duke përfshirë një shënim dhe në faturën e ujit të konsumatorit. Operatori, brenda orarit zyrtar të punës, vë në dispozicion të konsumatorëve dokumentacionin për tarifën aktuale. Operatori, publikon në vende të ndryshme ku ka akses publiku, vendimin për ndryshimin e tarifave, por duke mos u kufizuar vetëm në pikat ose zyrat e tij të marrëdhënieve me konsumatorin.

##### Neni 18

##### Monitorimi i zbatimit të tarifave

1. ERRU-ja monitoron zbatimin korrekt të tarifave, siç përshkruhet në këtë metodologji. Nëse ERRU-ja konstaton se operatori zbaton një tarifë që është mbi tarifën e ndryshuar e të miratuar prej saj, do të zbatojë dënimet për kundërvajtje të përcaktuara në nenin 32/1, pika

“b”, të ligjit nr. 8102 (i ndryshuar). Në rast se operatori ka vënë tarifë më të lartë për konsumatorët, ai do të korrigjojë tarifën në ciklin pasues të faturimit dhe do të rimbursojë shumën e vënë mbi tarifën e rregullt të miratuar nga ERRU-ja për çdo konsumator të prekur nga aplikimi i parregullt i tarifës së ndryshuar të miratuar.

#### VENDIM

Nr. 43, datë 21.12.2015

#### PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 9, DATË 30.4.2012, “PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS SELENICË”

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/“a”, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator

#### VENDOSI:

Në vendimin nr. 9, datë 30.4.2012, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjellës Selenicë” bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Drejtues ligjor: Gazmir Beqaj”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Avni Dervishi

#### VENDIM

Nr. 44, datë 21.12.2015

#### PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 13, DATË 13.6.2012, “PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS BULQIZË”

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/“a”, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator



## VENDOSI:

Në vendimin nr. 13, datë 13.6.2012, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjellës Bulqizë”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:  
“Drejtues ligjor: Nedion Muça”.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
**Avni Dervishi**

## VENDIM

**Nr. 45, datë 21.12.2015**

**PËR SHFUQIZIM VENDIMI**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, Komisioni Kombëtar Rregullator

## VENDOSI:

Vendimi nr. 34, datë 23.11.2015, “Për tarifën e shitjes së ujit me shumicë për sh.a. UK Sarandë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
**Avni Dervishi**

**NDREQJE GABIMI TEKNIK**

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1045, datë 23.12.2015, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 238, datë 6 janar 2016, në pikën 3, të këtij vendimi, bëhet korrigjimi i gabimit teknik, si më poshtë:

Nr. 21 ndryshon dhe bëhet 2.





|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve  
Zyrtare Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë